



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241512
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607199

Në çështjen juridike të : **AC-I-23-0247-A0001**

Paditës/Ankues

A B, fshati P, Prizren, me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin **B I**, Prishtinë

Kundër:

E paditura

N.SH. “Ramiz Sadiku” (në likuidim), Prizren,, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-3057, të datës 14 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paditësit është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-3057, i datës 14 prill si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ017-0004/0014 i datës 10 mars 2014, lidhur me pjesën e kërkesës për pagat e papaguara.
3. Obligohet e paditura që për pagat e papaguara për periudhën 1 korrik 1999 deri 19 dhjetor 2005 t'i paguaj paditësit shumën prej 237.00 euro, interesin ligjor në shumë prej 23.70 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 18 prill 2014, paditësi kishte parashtruar një ankesë në DHPGJS kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. PRZ017-0004/0014 të datës 10 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 në shumën bruto prej 243.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme mbi bazën e parashkrimit, pasi që një kërkesë e tillë monetare e çfarëdo lloji, që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që e ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale midis dy palëve duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit, konkretisht më së voni deri më 1 korrik 2002.

Në ankesën e paditësit theksohet se vendimet e AKP-së nuk kanë bazë juridike valide pasi që Ligji për Punën e Bashkuar (LPB) nuk është ligj në fuqi në Kosovë që nga viti 1989 por edhe sikur të ishte në fuqi ky nen përsëri nuk do të mund të kishte parashkrim sepse shkaktar i vetëm i saj do të ishte Autoriteti i Likuidimit-AKP që nuk i ka përmbushur detyrimet e pagesës me kohë prandaj do të ishte e papranueshme që kjo e drejtë e themeluar me ligj t'i mohohet punëtorit për shkak të vonesës së AL-së. Andaj, kishte propozuar që të anulohet vendimi i AL-së dhe të urdhërohet AL që të miratoj kërkesën e punëtorit të N.SH-së në shumën e përcaktuar në vendimin e AL-së me 10% interes. Ankesës i kishte bashkëngjitur: kopjen e letërnjoftimit, autorizimin për përfaqësim si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ017-0004/0014 të datës 10 mars 2014.

Me datë 30 shtator 2015, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë për plotësimin e padisë, në të cilën theksohet se e paditura ishte e obliguar që për çdo kontratë apo marrëdhënie të përhershme të punës e cila është ndërprerë si rezultat i privatizimit të njoftonte zyrtarisht punëtorin për ndërprerjen e kësaj marrëdhënie/kontratë dhe këtë detyrë ajo e realizon duke lëshuar një dokument zyrtar-Letër Pezullimin me të cilën e njofton punëtorin me arsyet e ndërprerjes së parakohshme të kontratës dhe merrte përsipër përgjegjësinë-detyrimet e deriatëhershme. Nga praktika gjyqësore e Kolegjit të Apelit, përkatësisht nga rasti i S B për kërkesën për paga të papaguara rasti nr. AC-I-14-0323-A0001 i datës 12 mars 2005, në faqen e pestë të Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit kishte konstatuar se Letër Pezullimi i lëshuar nga AKM/AKP është njohje

e detyrimeve ndaj kreditorëve pra e detyrimit të pagesës së pagave të papaguara “Kolegji i Apelit nuk pajtohet me pohimin e AKP-së se letra informuese e datës 17 nëntor 2006 dërguar paditësit ka pasur karakter të njoftimit vetëm për të drejtën në 20 % por kjo letër flet edhe për paga dhe kërkesa tjera kreditore që mund t’i ketë paditësi ndaj N.SH-së në likuidim. Andaj, kishte propozuar që të miratohet si e bazuar padia e paditësit, ndërsa të anulohet vendimi i të paditurës, ashtu që AL në emër të pagave të papaguar t’i paguaj paditësit shumën e borxhit kryesor prej 237.00 euro bashkë me interesin ligjor si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit.

Me datë 23 mars 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se parashtruesi në rastin konkret nuk kishte treguar se cili nen i ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL gjatë marrjes së vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur neni 74.2. të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP. Tutje AKP kishte konsideruar se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, konkretisht më së voni deri me 1 korrik 2002. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e paditësit si e papranueshme apo e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ017-0004/0014 të datës 10 mars 2014 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 14 prill 2023, shkalla e parë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-3057 kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kishte vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ017-0004/0014 të datës 10 mars 2014. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet se neni 42 pika 2 Ligjit për DHPGJS-në parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale, ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, e nëse pala e tillë dështon të paraqesë apo dorëzoj provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë. Neni 7 i Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që palët kanë për detyrë t’i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Në rastin konkret gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i N.SH-së por nga shkresat e lëndës gjykata arrinë në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi

relevante që dëshmon se N.SH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën për të cilën është ushtruar kërkesa dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara.

Me datë 3 maj 2023, paditësi kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-14-3057 të datës 14 prill 2023, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratohet në tërësi si e bazuar ankesa e ankuesit, ndërsa të anulohet Aktgjykimi i ankimuar ose lënda të kthehet në rigjykim, duke detyruar të paditurën që në emër të pagave të papaguara t'i paguaj paditësit shumën e borxhit kryesor prej 243.00 euro, kamatë vonesën deri në 3.5 % dhe kamatën me 8 % prej hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit. Në ankesë theksohet se gjykata në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore nuk i ka evidentuar fare provat vendimtare dhe të mos flasim që ato t'i çmoj me kujdes ashtu siç obligon ligji, madje as nuk është marrë me parashtrimin e provave në ankesën fillestare dhe në asnjë moment nuk kishte theksuar se përfaqësuesi i palës ankuese me anë të parashtrësës ka bërë plotësimin e padisë duke parashtruar të gjitha provat dhe duke kërkuar krahas borxhit kryesor edhe kamatën ligjore. Tutje, konsideron se gjykata duke mos marrë për bazë të gjitha parashtrimet e provave relevante ka bërë shkeljen e dispozitave materiale për arsye se nuk përkrahën të gjitha faktet e paraqitura nga palët, çka ndikon drejtpërsëdrejti në ligjshmërinë e aktgjykimit. Paditësi me 21 shkurt 2006 kishte pranuar nga AKM-ja njoftimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, i cili njoftim përmban *“Shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*. Pra, paditësi i ishte përmbajtur udhëzimeve të njoftimit të AKM-së dhe kur ka filluar procesi i likuidimit brenda afatit të paraparë ligjor kishte parashtruar kërkesat e tij. Gjithashtu, nga librezja e punës së paditësit vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në ndërmarrjen në fjalë dhe ishte pjesë e saj deri në ditën e privatizimit.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: Njoftimin e datës 21 shkurt 2006 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës, një listë të pagave të papaguara për punëtorët e N.SH “Ramiz Sadiku” për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, ku paditësi mban numrin rendor 14.

Me datë 15 nëntor 2023, AKP-ja ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës kundërshtare në të cilën propozon që të refuzohet ankesa si e pabazuar ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS, C-IV-14-3057 i datës 14 prill 2023, si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ017-0004/0014 i datës 10 mars 2014, lidhur me pjesën e kërkesës për paga të papaguara për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 në shumën prej 243.00 euro dhe ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për pagat e papaguara në shumë prej 243.00 euro, me Vendimin PRZ017-0004/0014 i datës 10 mars 2014, ishte refuzuar si e pavlefshme, me arsyetimin se paditësi nuk kishte ofruar ndonjë dëshmi se kishte paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar për të kërkuar borxhin e pretenduar dhe për të ndalë rrjedhën e afatit të parashkrimit.

Ankuesi në ankesën e dorëzuar në DHPGJS në shkallë të parë kishte bashkëngjitur si provë kopjen e letërnjoftimit, autorizimin për përfaqësim si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ017-0004/0014 të datës 10 mars 2014.

Shkalla e parë e DHPGJS-së e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar duke konstatuar që paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën për të cilën është ushtruar kërkesa dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara

Kolegji i Apelit i DHPGJS-së konsideron që refuzimi i kërkesës për pagat e papaguara për periudhën e lartcekur ishte veprim i drejtë nga ana e shkallës së parë të DHPGJS, pasi që paditësi përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit nuk kishte dorëzuar asnjë provë tjetër në mbështetje të ankesës së tij të paraqitur në DHPGJS.

Mirëpo, paditësi në ankesën e tij në shkallë të dytë kishte vazhduar të kërkoj kompensimin e pagave të pretenduara për periudhën dhe shumën e lartcekur dhe në mbështetje të ankesës kishte bashkëngjitur provat si në vijim: Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të datës 21 shkurt 2006, një kopje të librezës së punës, si dhe listën e të ardhurave personale të papaguara të punëtorëve të N.SH “Ramiz Sadiku” në Prizren për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, nga e cila listë mund të shihet që paditësi ka numrin rendor 14.

Në këtë rast Kolegji i Apelit vendosi ti pranoj këto prova në interes të drejtësisë edhe pse shkalla e parë kishte vendosur drejtë duke u bazuar në prova dhe shkresat tjera të lëndës që kishte në dispozicion.

Nga librezja e punës së paditësit mund të shihet qartë që i njëjti ka ofruar shërbime për ndërmarrjen në fjalë deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me 21 shkurt 2006 . Gjithashtu, nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, shihet që paditësi i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë me datë 21 shkurt 2006, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për paga të papaguara, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

Gjithashtu duke u bazuar në listën e të ardhurave personale të papaguara të punëtorëve të N.SH “Ramiz Sadiku” në Prizren për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005, ku paditësi ka numrin rendor 14 shihet që N.SH i kishte mbetur borxh të njëjtit shumën prej 243.00 euro për pagat e papaguara për periudhën e lartcekur.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit i njeh të drejtën paditësit në kompensim të pagave të papaguara në shumën prej 237.00 euro për periudhën nga 1 korrik 1999 deri më 19 dhjetor 2005 sipas parashtrësës për plotësimi e padisë të datës 30 shtator 2015 e cila duhet të paguhet nga Autoriteti i Likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit. Pjesa tjetër përtej kësaj shume e kërkuar me ankesë refuzohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi përveç borxhit kryesor ka kërkuar edhe interesin ligjor në shkallën 35 %. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, Kolegji i Apelit njeh të drejtën në interes ligjor prej 10% në shumë prej 23.70 euro e cila do t'i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Pasi që pala e paditur është palë e pasuksesshme në këtë lëndë, bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore lidhur me përfaqësimin nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
